



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 8, datë 27.02.2014

PËR

MIRATIMIN E BUXHETIT TË BYROSË SHQIPTARE TË SIGURIMIT TË VITIT 2014

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, nenit 42, pika 7 të Ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe nenit 10, të Rregullores nr. 2, datë 28.01.2010, “Për standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së BSHS-së”, me propozim të Byrosë Shqiptare të Sigurimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

KONSTATOI SE:

Byroja Shqiptare e Sigurimit, me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve nr. 02, datë 17.01.2014, ka miratuar strukturën organizative dhe projektbuxhetin e Byrosë për vitin 2014.

Gjithashtu me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve nr. 13, datë 21.02.2014, është miratuar një shtesë në projekt buxhetin në zërin “Investime” për realizimin e shërbimit të funksionimit të qendrës së informacionit, me qëllim implementimin e sistemit Bonus Malus. Kjo shtesë e projekt buxhetit është reflektuar në tabelën përmbledhëse të detajuar.

Referuar tabelës përmbledhëse të projekt buxhetit të detajuar rezulton se buxheti i vitit 2014, parashikohet në vlerën 53,967,270 lekë, 2% më shumë se buxheti i planifikuar i vitit 2013.

Në bazë të nenit 42, pika 7 të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, buxheti financohet nga të gjithë anëtarët e byrosë, në mënyrë të barabartë, brenda 30 ditëve kalendarike nga miratimi i tij prej Autoritetit.

Për sa më sipër Autoriteti,

V E N D O S I :

1. Miratimin e buxhetit të Byrosë Shqiptare të Sigurimit për vitin 2014, sipas tabelës bashkëngjitur.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Enkeleda SHEHI